

## **Raport Monitorimi viti 2024**

Në kuadër të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, të ligjit nr.97 dt.07.12.2023 ”Për buxhetin e vitit 2024”, të udhëzimit nr.14 datë 30.05.2023 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, është hartuar raport monitorimi për periudhën Janar – Dhjetor 2024, për institucionin e Avokatit të Popullit Ky raport mbështetet në vizionin por dhe detyrimet kushtetuese të Avokatit të Popullit, si institucion kombëtar në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në fokus të së cilit është ndërtimi i një shoqërie të bazuar në të drejtën në të cilën institucionet shtetërore janë llogaridhënëse ndaj qytetarëve dhe veprojnë në mënyrë transparente, të drejtë, efektive dhe efincente. Kjo përfaqëse është reflektuar në punën e institucionit për të garantuar, që institucionet publike të veprojnë në përputhje me standardet dhe aktet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut. Me një pozitë të tillë institucionale, pritshmëritë legjitime të publikut dhe të gjithë aktorëve dhe faktorëve të tjerë të shoqërisë sonë kanë qenë dhe janë ende të larta në krahasim me veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit.

Në funksion të kapaciteteve dhe burimeve institucionale dhe duke marrë parasysh realitetet politike, ligjore, sociale, ekonomike, zhvillimore dhe kulturore të Shqipërisë, ambicia strategjike e Avokatit të Popullit është të bëhet aktori kryesor në funksionimin e sistemit kombëtar të të drejtave të njeriut në Shqipëri.

- **Vështrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2024**

Në mbështetje të ligjit nr.97 dt.07.12.2023 ”Për buxhetin e vitit 2024”, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”- i ndryshuar, performanca e produkteve të buxhetit për institucionin e Avokatit të Popullit, sipas programit buxhetor të miratuar për periudhën Janar – Dhjetor 2024 paraqitet si më poshtë:

- **Programi - “Shërbimi Avokatisë”**

Buxheti i akorduar për këtë program (i vetmi program që ka institucioni i Avokatit të Popullit) ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit (DPP) të alokuara me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr.23917 prot, datë 28.12.2023 “Mbi detajimin e buxhetit për vitin 2024-2026”, shkresës nr.23917 /126 datë 01.2.2024 “Mbi detajimin e buxhetit për vitet 2024-2026 për shpenzime kapitale” të ndryshuar, si dhe qëllimin e arritjeve dhe objektivave të përcaktuar e të miratuara në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm (2024-2026)



- **Raporti i shpenzimeve faktike të programit sipas llogarive ekonomike për vitin 2024**

Fondet e akorduara si dhe rialokimet e bëra gjatë vitit për funksionimin e aktivitetit të institucionit të Avokatit të Popullit, , paraqiten në tabelat e mëposhtme:

## Informacion për fondet sipas llogarive ekonomike për vitin 2024.

Tabela nr. 1


Nr. Llog.	Emërtimi	Plani fillestar 2024	Plani i rishikuar viti 2024	Fakti viti 2024
600	Paga	129,125,000	131.625.000	130.278.144
601	Sig. Shoqërore e Shëndetësore	18,584,000	18,784,000	18.331.253
602	Mallra dhe shërbime të tjera	24,100,000	24,100,000	21.960.119
605	Transferta. Korente të Huaja	1,700,000	1,700,000	1.683.985
606	Transf për buxhetet familjare	700,000	1.506.104	818.572
600-231	Fondi të ardhurave nga marëveshje bashkëpunimi	2,638,379.35	10.551.533,34	7.503.491,43
231	Investimet	4,000,000	4,000,000	3.831.600
	<b>TOTALI</b>	<b>180,847,379.35</b>	<b>192.266.637,34</b>	<b>184.407.164,43</b>



- Informacion mbi realizimin e shpenzimeve në %

Tabela nr. 2

Nr. Llog.	Emërtimi	Plani i rishikuar 2024	Fakti 2024	Diferenca	Realizimi në %
600	Paga	131,625,000	130,278,144	1,346,856	98.98
601	Sig. Shoqërore e Shëndetësore	18,784,000	18,331,253	452,747	97.59
602	Mallra dhe shërbime të tjera	24,100,000	21,960,119	2,139,881	91.12
605	Transferta. Korente të Huaja	1,700,000	1,683,985	16,015	99.06
606	Transf për buxhetet familjare	1,506,104	818,572	687,532	54.35
600-231	Fondi të ardhurave nga marëveshje bashkëpunimi	10,551,533.34	7,503,491	3,048,042	71.11
231	Investimet	4,000,000	3,831,600	168,400	95.79
	<b>Totali</b>	<b>192,266,637.34</b>	<b>184,407,164.43</b>	<b>7,859,472.91</b>	<b>95.91</b>







- **Tabela nr.3 Përqindja e fondeve sipas llogarive ekonomike ndaj totalit për vitin 2024.**

Nr. Llog.	Emërtimi	Plani viti 2024	Struktura në %	Fakti viti 2024	Struktura në %
600	Paga	131,625,000	68%	130,278,144	71%
601	Sig. Shoqërore e Shëndetësore	18,784,000	10%	18,331,253	10%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	24,100,000	13%	21,960,119	12%
605	Transferta. Korente të Huaja	1,700,000	1%	1,683,985	1%
606	Transf për buxhetet familjare	1,506,104	1%	818,572	0%
600-231	Fondi të ardhurave nga marëveshje bashkëpunimi	10,551,533.34	5%	7,503,491	4%
231	Investimet	4,000,000	2%	3,831,600	2%
	<b>TOTALI</b>	<b>192,266,637.34</b>	<b>100%</b>	<b>184,407,164.43</b>	<b>100%</b>

- **Informacioni mbi fondet buxhetore për vitet 2015-2024.**

Nr.	Vitet	Miratuara					Totali
		600-601	602-606	231	Nr. i Punonjësve		
		Paga dhe sigurime	Shpenzime Operative	Investime	Nd/Komisioner	Gjithsej	
1	2015	75,500	16,000	4,000	21	51	95,500
2	2016	84,500	17,000	4,000	21	55	105,500
3	2017	84,500	18,000	4,000	21	56	106,500
4	2018	94,500	17,500	4,000	21	56	116,000
5	2019	104,500	18,600	2,000	21	56	125,100
6	2020	98,500	17,000	1,000	21	56	116,500
7	2021	98,500	17,500	3,000	21	56	119,000
8	2022	102,500	22,700	4,000	22	57	129,200
9	2023	108,000	26,000	4,000	24	59	138,000
10	2024	150,409	27,306	4,000	25	67	181,715



- **Viti 2024 Investimet**

	Emërtimi	Plani	Fakti	Realizimi në %
M660009	Blerje pajisje elektronike	2,694,000	2,694,000	100.00
M660001	Blerje pajisje dhe orendi zyre	1,306,000	1,137,600	87.11
	TOTALI	4,000,000	<b>3,831,600</b>	95.79

**Investimet për vitin 2024**



➤ **-Shpenzime Personeli**

- Realizimi i fondit të pagave reflekton strukturën dhe organikën e miratuar me shkresat e MF nr.23917/158 prot, datë 13.02.2024 “Miratimi i numrit të punonjësve për vitin 2024 dhe nr.20012/82 prot, datë 02.02.2024 “Dërgohet detajimi i numrit të punonjësve me kontratë, për vitin 2024”. Fondi i riakorduar për vitin 2024, për mbulimin e shpenzimeve për paga personeli është 131,625,000 lekë, ndërsa realizimi për periudhën Janar - Dhjetor 2024 është 130.278.144 lekë ose 98.98 % e fondit total për paga për vitin 2024.
- Realizimi i fondit për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore bazuar në planin e rialokuar për vitin 2024 prej 18.784.000 lekë është 18.331.253 lekë ose 97.59 % nga fondi total për sigurime shoqërore dhe shëndetsore për vitin 2024. Të dyja zërat së bashku paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore (600+601) për periudhën Janar –Dhjetor 2024 janë realizuar në masën 98.80 % ndaj planit buxhetor të alokuar, si rezultat i vakancave të krijuara.

➤ **Fondi i akorduar për shpenzime mallra e shërbime (llogari ekonomike 602)** për periudhën Janar – Dhjetor 2024 është 24.100.000, ndërsa realizimi Janar – Dhjetor 2024 është 21.960.119 lekë ose 91.12 % e fondit buxhetor vjetor. Për këtë periudhë shpenzimet operative, janë përdorur kryesisht për shpenzime kancelarie, elektrike, postare, uji, telefonike, postare, karburant, shërbime profilaktike, siguracion automjete,dieta brenda dhe jashtë vendit, shpenzime mirëmbajtje administrative, përkthime si dhe shpenzime për taksa të paguara bazuar në legjislacionin në fuqi.

- Fondi për transferta korente të huaja (**llogari ekonomike 605**) për vitin 2024 është 1,700,000 lekë, ndërsa realizimi për kuotat e anëtarësimit është 1.683.985 lekë ose 99.06 % ndaj buxhetit vjetor të alokuar.
- Fondi për transferta buxhetore familjare dhe individë (**llogari ekonomike 606**) për periudhën Janar – Dhjetor 2024, është 1,506,104 lekë, ndërsa realizimi është 818.572 lekë ose 54.35 % ndaj buxhetit të alokuar .
- Fondi i të ardhurave nga marrëveshjet e bashkëpunimit me donatorë të ndryshëm është 10.551.533,34 lekë të ardhura nga të cilat janë përdorur 7.503.491,43 lekë ose 71.11 % e të ardhurave totale..
- Fondi i investimeve akorduar nga buxheti i shtetit ( **llogari ekonomike 231**) është 4,000,000 lekë nga të cilat janë përdorur 3.831.600 lekë për pajisje elektronike dhe orendi zyre ose 95.79 % të fondit të miratuar.

